



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 03.02.2014

Hasan Preteni,
Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

Lënda: Raport në lidhje me zbatimin e objektivave dhe veprimeve që dalin nga Plan i Veprimit kundër Korrupsionit për periudhën Qershor - Dhjetor 2013

I nderuari z. Preteni

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), duke u bazuar në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit ka hartuar raportin për objektivat që n dërlidhen me mandatin ligjor të Ministrisë. Është vlerësuar se disa nga objektivat nga ky plan për periudhën 2013-2017 duhet të plotësohen në bashkëpunim të ngushtë në mes të Agjensionit Kundër Korrupsionit dhe komunave, ndërsa MAPL do të mbështesë realizimin e tyre.

Me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, MAPL është duke hartuar Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2014 - 2024. Pjesë e Strategjisë për vetëqeverisje Lokale është edhe reformimi dhe harmonizimi i legjislacionit bazë për vetëqeverisje lokale me legjislacionin e BE-së dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, që siguron forcimin e administratës komunale, në ofrimin e shërbimeve efikase dhe efektive për qytetarë.

MAPL, është duke punuar ngushtë me strukturat e zgjedhura komunale për të ndikuar në zbatimin e obligimeve ligjore përfshirë edhe obligimet që kanë komunat në raport me Agjensionin Kundër Korrupsionit. Ndërsa caktimi i pikave të kontaktit në të gjitha komunat që do të jenë në lidhje direkte me Agjensionin Kundër Korrupsionit nuk ka mundur të realizohet duke mos pasur instruksionet e duhura nga AKK si bartës të këtij procesi si dhe bazën si vijon;

- Planin se si do të raportojnë këto pika;
- Planin e veprimit lokal që duhet të hartohet dhe harmonizohet me legjislacionin lokal;
- Planprogramin e trajnimit për këto pika, plan ky i cili duhet të bazohet përsëri në një bashkëpunim të ngushtë AKK- MAPL;

Lidhur me objektivin specifik për raportimin e shkeljeve ligjore brenda periudhës kohore Janar – Dhjetor 2013 në MAPL pas shqyrtimit të akteve komunale ka vlerësuar se 35 akte të komunave nuk janë në pajtim me legjislacionin bazë për vetëqeverisje lokale. Këto të dhëna hollësisht janë paraqitur në raportin e funksionimit të komunave Janar Dhjetor 2013 i përgatitur nga MAPL, i cili mund të vihet në dispozicionin Tuaj në çdo kohë.

Nëse eventualisht keni ndonjë kërkesë plotësuese jemi në dispozicionin Tuaj.

Me respekt,



Sekretar i Përgjithshëm,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: *Burim Sadiku, Agjensioni Kundër Korrupsionit*
Udhëheqësve të departamenteve në MAPL
Arkivit të Ministrisë

Sekretar i Përgjithshëm,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MATRICA

Raport në lidhje me zbatimin e objektivave dhe veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit kundër Korrupsionit për periudhën Qershor - Dhjetor 2013ⁱ
Qeverisja Lokale/Ministria e Administrimit Lokal

Nr	Objektivat Strategjike të Sektorit	Nr	Objektivat Specifike të Planit të Veprimit	Veprimi/Masa	Afati	Institucioni Përgjegjës (Bashkëpunues)	Treguesit e Suksesit
II. QEVERISJA LOKALE							
II.1	<i>Promovimi i integritetit dhe profesionalizmit të pushtetit lokal</i>	II.1.1	Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të integritetit në komuna	Hartimi dhe miratimi i planeve të integritetit në të gjitha komunat	2013	MAPL, AKK (Kuvendi Komunal)	Ne nuk posedojmë ndonjë plan veçantë të integritetit. Por sipas informacionit tuaj një plan i tillë është duke u hartuar në nivel nacional, dhe sapo të jetë i parovuar edhe në do të veprimet në bazë të këtij plani dhe në koordinim me AAK.
				Krijimi i komisioneve në kuvendet komunale për mbikëqyrjen e zbatimit të planeve të integritetit	2014	Kuvendi Komunal	
				Organizimi i trajnimeve adekuatë dhe edukim për autoritetet komunale që kanë detyrë zbatimin e planeve të integritetit	2014-15	AKK MAPL ZKM Shoqëria Civile	

		II.1.2	Zvogëlimi i ndikimit politik në emërimin e shëfave të departamenteve të qeverisë lokale	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale no.03/L-040, në veçanti nenet 58, 62 dhe 65, dhe fujta e kriterëve të profesionalizmit për emërimin e shëfave të departamenteve	2013	MAPL Kuvendi	Është duke u hartuar plani konceptual që i paraprin ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale; Dhe një ndër ndryshimet e propozuara do të mund të jenë edhe nenet 58, 62 dhe 65 të Ligjit për Vetëqeverisja Lokale no. 03/L-040
				Shpallë konkurs për pozitë e shëfave të drejtorateve me kërkesat profesionale të bazuara në Ligjin e ndryshuar për Vetëqeverisje Lokale	2014 – në vazhdim	Komuna	Në vazhdim vetëm pas amendamentimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale no. 03/L-040
II.2	Përforcimi i transparencës për të inkurajuar pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në punën e pushtetit lokal.	II.2.1	Forcimi i transparencës në miratimin, planifikimin dhe zbatimin e akteve komunale	Ofrimi dhe mirëmbajtja e qasjes në internet në akte kryesore lokale (planet, kontratat, etj.)	Në vazhdimësi (shqyrtim në fund të fund 2014)	Komuna	Baza ligjore për publikimin e akteve komunale është Rregullorja Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. 10 komuna kanë azhurnuar rregullisht ueb-faqet zyrtare me publikimin e akteve të

						kuvendeve, • 14 prej tyre vetëm pjesërisht ndërsa • 10 nuk i kanë publikuar fare.Nr. i ueb-faqeve komunale që mbahen\ MAPL është duke punuar ngushtë me komunat si në anën legjislative e po ashtu edhe atë aplikative për avancuar dhe ndihmuar komunat që të gjitha aktet të jenë të publikuara dhe transparente. Po ashtu në faqen zyrtare të MAPL-s mund të gjeni 15 raporteⁱⁱ për komunat për vitin për vitin 2013.
						Sa i përket takimeve publike me qytetarët nipër komuna janë organizuar këto takime. • 13 komuna kanë organizuar nga një (1) takim publik me qytetarë, • 17 komuna kanë mbajtur nga 2 takime publike me qytetarë,
						Kuvendi Komunal, Qeveria, Komunalet, Shoqëria Civile
						Në vazhdimësi (shqyrtim vjetor)
						Të sigurojë që planifikimi dhe miratimi i akteve komunale është bërë në mënyrë transparente

					MAPL janë drejtuar edhe ankesa lidhur me Aktet ligjore të komuna.
					- Për periudhën Janar – qershor janë pranuar në MAPL 52 ankesa kundër akteve të nxjerra në. - Nga ankesa e shqyrtuara janë kthyer 37 përgjigje.
			2015	Krijimi i strukturave të përziera (kuvendet komunale, OJQ-të) për monitorimin e përbashkët të zbatimit të programeve komunale kundër-korrupsion	Qeveria Komunale (Shoqëria Civile)
			2013	Caktimi i pikave të kontaktit përgjegjës për masat kundër-korrupsion në komuna, fuqizimin e tyre dhe trajnim për raportim të rregullit dhe të përgjegjshëm	Qeveria Komunale (AKK dhe MAPL)
					Pikat e kontaktit është paraparë që të caktohen nga një iniciativë e përbashkët AKK-MAPL, por ne nuk kemi marrë instruksion më nga AKK se si do të jetë pozita e këtyre pikave, objektivat, planet lokale të antikorrupsionit si dhe trajnimi i tyre duhet të parashihet po ashtu. Ne jemi të gatshëm të mbështesim iniciativat nga AKK.

[illegible]

¹ Të dhënat e përfshiar në këtë matricë janë mledhur kryesisht nga raporte vjetore, si dhe nga konsultimet/hulumtimet brenda MAPL-s

ii <http://mapl.rks-gov.net/Raporte/2012.aspx>